

# **Certifikimi i kompanive - Domosdoshmeri por, kujdes!**

**Artikull: Revista MONITOR 46/577**

**Agim Bufi**  
**Konsulent certifikimi**

Fokusi mbi "cilësinë", ka qenë gjithmonë një pikë e rëndësishme për ata që bëjnë produktet, por është edhe një atribut më pak i prekshëm për ata të cilët ofrojnë shërbime. Ka kohë që çështja e certifikatave të cilësisë ka përshkuar ngadalë dhe gradualisht tregun si një demonstrim konkret të angazhimit dhe seriozitetit ndaj konsumatorit. Sot, studiues dhe profesionistë bien dakord në konsiderimin e modelit të certifikimit të cilësisë, si një mjet i rëndësishëm dhe praktik për inovacionin e menaxhimit .

Norma UNI EN ISO 9001, e rinxjerrë në vitin 2008 në versionin e ri, rregullon sistemin e menaxhimit të cilësisë së produkteve dhe shërbimeve për të vetmin qëllim, atë të marrjes së kënaqësinë se konsumatorit final. Modeli i referencës është zbatuar në bazë të metodologjise së planit: Do Check Act, ( DCA ), e cila konsiston në krijimin e një rreth virtuoze në favor të përmirësimit të efikasitetit dhe efektivitetit të biznesit.

## **C'permban Sistemi I menaxhimit të Cilësisë?**

ISO 9001-2008 përfaqëson sot pikën e referimit të njohur në nivel botëror për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së ndërmarrjeve të të gjithë sektoreve prodhuese dhe të të gjitha përmasave. Normat e familjes ISO 9000 janë udhëzime se si një ndërmarrje duhet të veprojë për të siguruar dhënien e një shërbimi cilësor dmth që i përgjigjet asaj që kërkohej nga klienti. Certifikimi sipas kësaj familjeje normash është një certifikim sistemi dhe jo produkti dmth nuk certifikohet malli ose shërbimi por sistemi I administrimit të firmes.

UNI EN ISO 9001-2008 vendos në qendër të realizimit:

Klientin dhe përbushjen e plotë të kërkesave të tij.

Vizionin e firmes si një bashkësi procesesh që mes tyre kanë një marrëdhënie të ngushtë;

Të japë produkte/shërbime që i përgjigjen në mënyrë konstante kërkesave të përcaktuara;

Ndjekjen e një përmirësimi e inovacioni të vazhdueshëm të paraqitjeve.

Të administrohet cilësia, nënkupton administrimin e efikasitetit dhe eficiencës së proceseve të veta përmes:

Njohjes, menaxhimit dhe monitorimit të proceseve;

Aftësisë së përfshirjes së burimeve njerezore;

Centralizimi i rolit drejtues në nivele të larta të firmes.

Të punosh me efikasitet dhe efektshmëri ka si rrjedhojë zvogelimin e kostove. Me aplikimin e cilësisë së plotë, pra arrihet një zotërim i tregut me lehtësi me një cilësi më të mirë dhe çmime më të ulta.

## **Perparesite**

Administrimi I efikasitetit të veprimtarisë së vet, duke ndihmuar në përmirësimin e punës së gjithësecilit dhe në përgjigjen ndaj kërkesave të veta;

Perfitimi I një sistemi monitorimi dhe matjesh që garanton efikasitetin e kontrolleve;

Rritja e konkurrencës dhe e besueshmërisë, dallueshmërisë në tregun referencës;

Të paturit e një certifikimi me vlefshmëri ndërkombëtare, element shtesë për pjesëmarrje në tendera.

## **Perse te certifikojme sistemin**

Zoterimi i nje kualifikimi qe te lejoje pjesmarrjen ne tendera ose gara qe e parashikojne kete kusht si te domosdoshem.

Te verifikohet venja korrekte ne zbatim e sistemit te menaxhimit;

Te behet e ditur qe permiresimi I arritur varet nga nje sistem menaxhimi dhe jo nga insiativa vetjake;

Te paturit e nje stimuli te vazhdueshem per permiresimin dhe permbushjen e kenaqesive te klientit.

## **Kujdes!**

Tregu shqiptar i certifikimit është pushtuar gjithnjë nga organe ( ente ) certifikues ose organe pseudo çertifikimi që leshojne certifikata pa qene te akredituara ose në mungesë të rregullave bazike të përcaktuara nga standardet ndërkombëtare.

Në kete pikepamje, behet shume e rendesishme, zgjedhja e Organizmit të tretë i cili ,duhet të vërtetojë se procesi i prodhimit të kompanisë eshte ne perputhje te plote te standarteve europiane.

Qëllimi i këtij artikulli është që të shpjegojë botën e çertifikimit duke dhene informacionin e duhur se cfare rruge duhet te ndjeke nje kompani, per tu certifikuar realisht sipas standarteve europiane dhe per te parandaluar njerëz të paskrupullt qe levizin me canta ne duar, te cilet japin certifikata jo reale duke e deformuar kete treg te rendesishem.

Le te sqarojme disa pika kyce te botes se certifikimit nepermjet disa pyetjeve dhe përgjigje.

## **C'fare eshte akreditimi ?**

Akreditimi është njohja se një organ certifikues duhet të certifikojë dhe te jape nje certifikatë qe te jete e njohur në Evropë dhe ndërkombëtarisht.

Akreditimi është një mekanizëm që ndikon në rritjen e besueshmërisë dhe ndihmon autoritetet, ekonominë dhe shoqërinë që të gjykojnë nëse laboratorët e provave, organizmat e inspektimit , certifikimit ( Organizma të Vleresimit të konformitetit) plotësojnë detyrat specifike.

Akreditim është procedura në bazë të së cilës një organizem i autorizuar, vlerëson kompetencën e një organizmi të vlerësimit të konformitetit për të kryer detyra specifike të tilla si testim, kalibrim, certifikim dhe inspektim. Kompetenca është çelësi për të siguruar transparencën, besueshmërinë dhe efikasitetin e shërbimeve që ofrojnë Organizmat Vlerësimit të Konformitetit të Akredituara .

## **Cilet jane Entet Akreditues ?**

Entet Akreditues përfaqësojnë librin e Enteave të certifikimit në çdo vend dhe që njihen nga ministritë e ndryshme të tilla si:

Ne Shqiperi DA, [www.dpa.gov.al](http://www.dpa.gov.al); ne Greqi ECYD, [www.esyd.gr](http://www.esyd.gr); ne Itali ACCREDIA, [www.accredia.it](http://www.accredia.it); ne Spanje ENAC, [www.enac.es](http://www.enac.es); ne Angli UKAS, [www.ukas.com](http://www.ukas.com); ne Zvicer SAS etj...

## **Pse certifikata që mbajnë akreditimin janë të njohura në mbarë botën?**

Sepse organet e akreditimit janë te njohur nga EA (Akreditimi European) dhe IAF (Forumi i Akreditimit Internacional), që kanë nënshkruar paktin e njohjes reciproke MLA.

## **Si mund te verifikojme qe nje Organizem certifikues eshte i akredituar ?**

Duhet të pyesni se ku Organizmi certifikues është akredituar, dhe kontrolloni në faqen e internetit të organit akreditues nëse është i pranishëm.

## **Si mund ta kontrolloni Organin Akredituese është i njohur dhe i IAF ka nënshkruar marrëveshje reciproke të njohjes (MLA)?**

Thjesht shkoni në faqen e internetit [http://www.iaf.nu/articles/IAF\\_MLA/14](http://www.iaf.nu/articles/IAF_MLA/14), dhe do të shihni listën e organeve të akreditimit të njohura, duke përfshirë edhe nënshkruesit e MLA.

**Nje Organizem certifikues i akredituar a mund te leshoje cfaredo certifikate?**

Jo, Organizmi certifikues mund të lëshojë vetëm ato certifikate për të cilën ai është akredituar.

Për shembull, për të dhënë një certifikatë në përputhje me UNI EN ISO 9001, për një kompani ndërtimi, trupi certifikues duhet të jetë i akredituar në sektorin EA 28.

**Si mund ta verifikojmë sektorin apo normën ku organizmi është i akredituar?**

Thjesht shkoni në faqen e internetit të organit akreditues dhe kontrolloni emrin e organizmit, rregullat për të cilat është akredituar dhe e njohur për çdo nga fushat standard.

**Nqs ka dyshime per nje certifikate si mund ate ta kontrollojme?**

Kerkohet ne faqen e internetit të Organizmit certifikues që e ka lëshuar atë, ose kontaktoni direkt me akreditimin. ( Detajet e kontaktit janë në certifikat ).

**Nje organizem certifikues a mund te beje konsulence kompanise per tu certifikuar?**

Jo, një organ certifikimi nuk mund të bëjë çdo lloj këshille për menaxhimin e sistemeve. Perkundrazi kjo përbën një konflikt interesi. Organizmi certifikues duhet të kontrollojë se, sistemi i cilësisë, që e ka bërë kompania vete, ose nëpërmjet një konsulenti, është e përshtatshme dhe përmbush standardet e referimit.